

European Spatial Integration: The Western Balkans Discontinuity | Integrimi hapësinor i Evropës: mosvijimësia e Ballkanit Perëndimor

Giancarlo Cotella^a

Summary

The EU spatial agenda has progressively gained momentum since the end of the 1980s. A number of spatial strategies and visions have been produced, reflecting upon ongoing development trajectories and, more pragmatically, providing ground upon which to establish redistribution choices. This process has had to take into account the progressive widening of the EU, whereas the enlargement of territories presenting different socio-economic and territorial characteristics has challenged the EU's attempt to promote economic, social, and territorial cohesion. In light of this, with the enlargement to the Western Balkan region on the agenda, it is time to reflect upon its implications for the future of the EU's spatial development.

Keywords: European Union, Enlargement, Western Balkan Region, Spatial Visions, Territorial Cohesion

Përmbledhje

Axhenda e BE-së për territorin ka marrë gjithnjë e më shumë vull duke filluar nga fundi i viteve 1980. Në atë periudhë, u hartuan një sërë strategjish dhe vizionesh për territorin, të cilat reflektonin mbi trajektoret e zhvillimit të asaj kohe dhe, në një aspekt më praktik, ofronin bazat mbi të cilat do të mbështeteshin zgjedhjet që lidheshin me rishpërndarjen. Ky proces, duhej të merrte në konsideratë zgjerimin e vazhdueshëm të BE-së, ndërkohë që zgjerimi drejt territoreve që shfaqnin karakteristika të ndryshme socioekonomike dhe territoriale paraqiste një sfidë për përpjekjen e BE-së për të promovuar kohezion ekonomik, social dhe territorial. Nga ky këndvështrim, me shtrirjen në rajonin e Ballkanit Perëndimor të përfshirë në axhendë, ka ardhur koha të reflektohet mbi implikimet që kjo shtrirje do të ketë në zhvillimin e ardhshëm hapësinor të BE-së.

Fjalë kyçe: Bashkimi Evropian, zgjerimi, rajoni i Ballkanit Perëndimor, vizionet hapësinore, kohezioni territorial

Contact | Kontakt

^agiancarlo.cotella@polito.it (Corresponding author)

Interuniversity Department of Regional and Urban Studies and Planning (DIST)
Politecnico di Torino, Viale Mattioli 39, 10125, Torino, Italy, www.polito.it

Thirty Years of Competing European Spatial Visions

The process of European integration is composed of two main dimensions (Berglof, et al., 2008): (i) a widening dimension, with more and more territories progressively joining the supranational sovereignty of the European Union (EU), and (ii) a deepening dimension, with the member states that, by consolidating their agreements in treaties, progressively enlarge the scope and boundaries of such sovereignty. A significant step in this direction took place throughout the 1980s, with the establishment of the Single European Market, the EU's institutional answer to globalisation trends. Such a step has been accompanied by a growing attention to the potential territorial imbalances that it may have triggered. As a matter of fact, the inclusion of economic and social cohesion in the Single European Act of 1986, and the subsequent reform of the Structural Funds in 1988, constitute evidence of the relevance of balanced spatial development as a political condition for economic integration.

As a consequence, unprecedented attention to territorial development dynamics rose all of a sudden (Faludi, 2001). On the one hand, the establishment of the Single European Market exacerbated competition between European cities and regions, leading to increased spatial polarisation and territorial imbalances. On the other hand, the EU instituted a comprehensive redistribution policy aiming at slowing these trends and supporting those territories that were losing out (Williams, 1996). It was then that the need for pan-European spatial representations of these phenomena became urgent for the first time. Several attempts were made to map the changing economic space of Europe at the level of cities and regions (Dühr, 2007). In the 1980s, these studies focused on the representation of changing urban hierarchies by using a variety of traditional economic indicators (GDP, unemployment, and production structure, among others) (Cheshire, et al., 1986; Cheshire & Magrini, 1999). They constituted a first attempt to measure the comparative incidence of spatial problems in the largest urban regions of the EU and showed how, between the 1970s and the 1980s, the most

30 vjet vizione evropiane konkurruese për territorin¹

Procesi i integritimit evropian është i përbërë nga dy dimensione kryesore (Berglof et al., 2008): (i) një dimension i zgjerimit, me gjithnjë e më shumë territore të reja që i bashkohen vazhdimisht sovranitetit mbikombëtar të Bashkimit Evropian (BE) dhe (ii) një dimension i thellimit me shtetet anëtare që, duke konsoliduar marrëveshjet e tyre në traktate, zgjerojnë gjithnjë e më shumë rrezen e veprimit dhe kufijtë e këtij sovraniteti. Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim u hodh gjatë viteve 1980 me krijimin e Tregut të Përbashkët Evropian, si përgjigjja institucionale e BE-së ndaj tendencave të globalizimit. Ky hap u shoqërua nga një vëmendje gjithnjë e më e madhe ndaj çekuilibre me të mundshme territoriale që ai mund të kishte shkaktuar. Në fakt, përfshirja e kohezionit ekonomik dhe social në aktin e Tregut të Përbashkët Evropian në 1986 dhe reforma pasuese e Fondeve Strukturore në 1988 përfaqësojnë po aq një dëshmi të rëndësishme të zhvillimit të ekuilibruar hapësinor, sa dhe një kusht politik për integrimin ekonomik.

Si pasojë, një vëmendje që nuk ishte hasur kurrë më parë u zgjua befasisht ndaj dinamikave të zhvillimit të territorit (Faludi, 2001). Nga njëra anë, krijimi i Tregut të Përbashkët Evropian e thelloi konkurrencën mes qyteteve dhe rajoneve evropiane, duke çuar në rritjen e vazhdueshme të polarizimit hapësinor dhe çekuilibre me territoriale. Nga ana tjetër, BE-ja ngriti politika gjithëpërfshirëse të rishpërndarjes, që synonin të zbusnin këto tendenca dhe të mbështesnin territoret që ishin duke humbur në këtë garë (Williams, 1996). Pikërisht në atë moment, për herë të parë, u bë urgjente nevoja për një përfaqësim hapësinor panevropian të këtyre dukurive. Nisën të bëheshin tentativa të ndryshme për të krijuar një hartë të hapësirës ekonomike në ndryshim e sipër të Evropës, në nivel qytetesh dhe rajonesh (Dühr, 2007). Në vitet 1980, studimet u përqendruan në përfaqësimin e hierarkive urbane që po ndryshonin duke përdorur një sërë treguesish ekonomikë tradicionalë (PBB-në, papunësinë, strukturën e prodhimit etj.) (Cheshire, et al., 1986; Cheshire & Magrini, 1999). Këto përfaqësuan një tentativë të parë për të matur incidencën e krahasuar të


competitive cities overlapped with the main administrative poles (Brussels, Strasbourg, and Bonn) and with a number of cities in Germany, Denmark, and Northern Italy.

The most characteristic spatial perspective of Europe produced in those years is the so-called 'blue banana' (Figure 1a), first mapped in a study for the French regional planning authority DATAR (Brunet, 1989). This study represents a dominant development axis running from London to Milan, including the Randstad and West Germany, but excluding Paris and most of France. A few years later, the EUROPE 2000 and EUROPE 2000+ studies (CEC, 1994; 1996) were commissioned by the EU, analysing European cities' ranking concerning their position in the Western European urban hierarchy, where the differentiation of development between the urban economies of the European north in relation to the economies of the south showed rather obvious disparities. At the same time, parallel studies started to reflect on the potentials and challenges of the approaching EU eastern enlargement, suggesting an alternative development corridor that had been effectively represented by the so-called Central European

problemeve të hapësirës në rajonet më të mëdha urbane të BE-së dhe treguan se si, mes viteve 1970 dhe 1980, qytetet më konkurruese patën një mbivendosje me polet kryesore të administratës (Bruksel, Strasbourg, Bon) dhe me një sërë qytetesh në Gjermani, Danimarkë dhe Italinë e Veriut.

Perspektiva hapësinore më karakteristike e Evropës, që lindi gjatë atyre viteve, është e ashtuquajtura 'banania blu' (Figura 1a), paraqitur për herë të parë në një studim për autoritetin rajonal francez të planifikimit DATAR (Brunet, 1989). Ky studim përfaqëson një aks zhvillimi dominues që shkon nga Londra në Milano, duke përfshirë Randshtadin dhe Gjermaninë Perëndimore, por duke përjashtuar Parisin dhe pjesën më të madhe të Francës. Disa vite më vonë, BE-ja porositi studimet me shumë rëndësi në këtë aspekt EUROPE 2000 dhe EUROPE 2000+ (CEC, 1994; 1996), të cilat analizonin renditjen e qyteteve evropiane në sistemin hierarkik urban të Evropës perëndimore, duke zbuluar pabarazi të dukshme midis ekonomive urbane të Evropës së veriut dhe ekonomive të jugut. Në të njëjtën kohë, studime paralele nisën të reflektonin mbi potencialet dhe sfidat e zgjerimit lindor të BE-së që po afrohej,

Figure 1 | Figura 1. The Blue Banana (1a) and the Central European Boomerang (1b) | Banania Blu (1a) dhe Bumerangu i Evropës Qendrore (1b)



Source | Burimi: Brunet (1989) and Gorzelak (1996), respectively | Brunet (1989) dhe Gorzelak (1996), përkatësisht

Boomerang (Gorzela, 1996), a banana that mirrors its blue sister on the other side of the iron curtain (Figure 1b).

Overall, the spatially competitive processes represented by the described visions could be seen as an all-encompassing concern, presenting obvious links with criteria such as geographical position, economic strength, and social character of places, but also with spatial integration in terms of flows and barriers, spatial homogeneity and discontinuity, and cooperation between spatial entities. Moreover, spatial patterns change according to topics and scales, such as the effect of national borders on goods flows and the relative decrease in wealth differences between countries, rather than within them. Differences between regions provide opportunities for trade and exchange and can create flows that, in turn, can reduce spatial differences or increase them. This clearly constitutes a challenge for the ever-enlarging European integration project and pinpoints the importance of cooperation between spatial entities in order to achieve spatial integration, underlining the necessity to simultaneously understand and promote spatial integration at all spatial scales (Kotios, et al., 2005).

Following such inputs, the EU launched a process that culminated with the publication of the European Spatial Development Perspective (ESDP) just before the turn of the millennium (CEC, 1999). This document clearly acknowledges the dynamics of spatial competition represented by the described visions, as well as the risks implicitly brought about from a development model centred on a strong core progressively leaving behind the rest of the Union. Such a development trend started to be perceived as problematic, as it is clearly represented by the 50-40-20 Pentagon (Figure 2), the area included within the cities of London, Paris, Milan, Munich and Hamburg that, despite accounting for only 20% of the EU's surface, hosted 40% of the population and produced as much as the 50% of the GDP (Schön, 2000).

As a reaction, a number of alternative representations were produced, to dispel the vision of a two-speed Europe, where stronger territories prevail in a purely competitive game. These representations are founded on the concept of polycentric spatial development that, born in

duke sugjeruar një korridor alternativ zhvillimi që përfaqësohej në mënyrë efikase nga i ashtuquajti Bumerang i Evropës Qendrore (Gorzela, 1996): një banane dhe pasqyrimi i saj ngjyrë blu në anën tjetër të 'perdes së hekurt' (Figura 1b).

Në përgjithësi, proceset e konkurrencës hapësinore të përfaqësuara nga vizionet e përshkruara më lart mund të shihen si objekte të një shqetësimi të gjithanshëm, duke qenë se shfaqin lidhje të dukshme me kritere të tilla si, pozicioni gjeografik, fuqia ekonomike dhe karakteri social i zonave të përfshira, por edhe me integrimin hapësinor nga pikëpamja e flukseve dhe barrierave, homogjenitetit dhe mosvijmësisë hapësinore, si dhe bashkëpunimit mes subjekteve hapësinore. Më në detaj, modelet hapësinore ndryshojnë sipas temës dhe shtrirjes, siç është rasti i efektit të kufijve kombëtarë mbi flukset e të mirave materiale dhe i reduktimit relativ të dallimeve në nivelin e mirëqenies midis vendeve të ndryshme, më tepër sesa brenda një vendi të caktuar. Dallimet midis rajoneve krijojnë mundësi për treg dhe shkëmbime dhe mund të krijojnë flukse të cilat, nga ana e tyre, mund të reduktojnë dallimet hapësinore sikurse dhe mund t'i rrisin ato. Është e qartë që kjo përbën një sfidë për projektin evropian të integritit që është gjithnjë në rritje, si dhe nxjerr në pah rëndësinë e bashkëpunimit midis subjekteve hapësinore për arritjen e integritit hapësinor, duke theksuar në të njëjtën kohë nevojën për të kuptuar dhe promovuar integrimin hapësinor paralelisht në të gjitha nivelet hapësinore (Kotios et al., 2005).

Në vijim të këtyre *inputeve*, BE-ja nisi një proces, i cili kulmoi me publikimin e Perspektivës Evropiane për Zhvillimin Hapësinor në periudhën e fundit të shekullit të 20-të (CEC, 1999). Ky dokument pranon hapur dinamikat e konkurrencës hapësinore të përfaqësuara nga vizionet e përshkruara, si dhe rreziqet e nënkuptuara që sjell një model zhvillimi i përqendruar në një bërthamë të fortë, i cili po linte gjithnjë e më mbrapa pjesën tjetër të Bashkimit. Kjo tendencë zhvillimi, sikurse tregon qartë pentagoni në Figurën 2, nisi ta perceptojë si problematike hapësinorën e përfshirë midis qyteteve të Londrës, Parisit, Milanos, Mynihut dhe Hamburgut të cilat, paçka se zënë vetëm 20% të sipërfaqes së BE-së, përmbanin 40% të popullsisë dhe arrinin të prodhonin 50% të PBB (Schön, 2000).

Figure 2 | Figura 2. The European 50-40-20 Pentagon | Pentagoni Evropian 50-40-20




Source | Burimi: Schön (2000)

the suggestive representation of the European 'bunch of grapes' (Figure 3) (Kunzmann & Wegener, 1991), was consolidated into the pivotal aim of the ESDP. The concept, brought forward by the document, aims at reinforcing the main European economic integration zones on the basis of a model of development borrowed and re-adapted from the United States (Figure 4).

An attempt to mix the two approaches, one more competition-oriented and the other focussing on polycentric development, has been developed by van der Meer (1998). In his 'red octopus' (Figure 5), the 'blue banana' remains the EU's economic core, but is integrated in a larger system of 'tentacles' expanding to the northern, eastern, and southern parts of Europe. Under this vision, Europe's traditional urban areas are combined and linked with other regions and cities, doubling the number of the EU's 'islands of innovation' (Copenhagen, Berlin, Warsaw, Vienna, Belgrade, Budapest, Rome, Barcelona, and Madrid), and intermediate agglomeration regions specialized in distinctive economic and innovative sectors (Hamburg, Braunschweig-Göttingen, Poznan, and Salzburg-Linz, among others). Overall, in his European Spatial Cohesion Scenario (the subheading of the 'red octopus'), van der Meer tries to combine the EU's policy goals of competitiveness and cohesion into a politically-oriented spatial development perspective that aims at achieving economic and

Figure 3 | Figura 3. The European 'bunch of grapes' | 'Bistaku i Rrushit' Evropian




Source | Burimi: Kunzmann & Wegener (1991)

Si përgjigje, u prodhuan një sërë prezantimesh alternative për të çrrënjësuar vizionin e një Evrope me dy shpejtësi, ku territoret më të forta kryesojnë në një lojë konkurrimi. Këto prezantime mbështeten në konceptin e zhvillimit hapësinor policentrik i cili, i lindur nën konceptin sugjestionues të bistakut të rrushit (Figura 3) (Kunzmann & Wegener, 1991), u konsolidua duke u shndërruar në qëllimin kryesor të ESDP. Ky koncept është çuar përpara nga dokumenti në fjalë, me synim përforcimin e zonave kryesore të integritimit ekonomik evropian, bazuar në një model zhvillimi të huazuar nga Shtetet e Bashkuara (Figura 4).

Një përpjekje për t'i ndërthurur këto dy qasje, njëra më e orientuar nga konkurrenca dhe tjetra e përqendruar në zhvillimin policentrik, është bërë nga van der Meer (1998). Në 'oktapodin e kuq' të zhvilluar prej tij (Figura 5), 'banania blu' mbetet bërthama e ekonomisë së BE-së, por është e integruar në një sistem më të gjerë 'tentakulash', të cilat shtrihen në pjesën veriore, lindore dhe jugore të Evropës. Sipas këtij vizioni, zonat urbane tradicionale të Evropës kombinohen dhe ndërliken me rajone dhe qytete të tjera, duke dyfishuar numrin e 'ishujve të novacionit' të BE-së (Kopenhageni, Berlina, Varshava, Viena, Beogradi, Budapesti, Roma, Barcelona dhe Madridi) dhe rajoneve të ndërmjetme të aglomeratit të specializuara në sektorë ekonomikë dhe novatorë të veçantë (Hamburgu, Braunschweig-Göttingen,

Figure 4 | Figura 4. The USA and European 'Economic Integration Zones' | Zonat e Integritimit Ekonomik të SHBA-së dhe Evropës




Source | Burimi: Mehlbye (2000)

social cohesion through a better balance between peripheral and central regions. This perspective would make Europe more competitive by connecting poor and rich regions and making use of endogenous potentials in the outer-regions.

Overall, the above shows how the last thirty years, and especially the 1990s, were a rich period for Europe in the field of spatial representation. These representations were often adopted by the EU as arguments upon which to establish its territorial development policies and interventions. Since then, the enlargement of the EU towards the east, in 2004 and 2007, have set in motion economic forces that have left a permanent mark on the continent by opening up spatial integration between East and West (Adams, et al., 2011). Whereas nowadays, economic stability and sustainable economic growth (clearly preconditions for the long-term political stability of the EU) characterise the majority of the EU member states. In the case of the Western Balkan region, the processes of integration and transition still face difficulties. The region is characterized by unfavourable structural adjustments that will be explored in more detail in the following section, together with the challenges that they represent for the future of the EU integration project.

Poznan, Salzburg-Linz, etj.). Në përgjithësi, në *Skenarin e Kohezionit Hapësinor Evropian* – që është dhe nëntitulli i 'oktapodit' – van der Meer përipiqet të kombinojë dy qëllimet e politikave të BE-së, atë të konkurrencës dhe atë të kohezionit, në një perspektivë të zhvillimit hapësinor të orientuar politikisht, i cili synon të arrijë kohezionin ekonomik dhe social përmes një ekuilibri më të mirë mes rajoneve periferike dhe qendrore, duke e bërë Evropën më konkurruese nëpërmjet vendosjes së lidhjeve mes rajoneve të varfra dhe të pasura dhe duke vënë në përdorim potencialet e brendshme në rajonet më periferike.

Në përgjithësi, sa më lart na bën të qartë se tridhjetë vitet e fundit dhe sidomos vitet 1990 kanë qenë një periudhë e pasur për Evropën në fushën e kornizave dhe koncepteve strategjike hapësinore dhe se shpesh këto korniza adoptoheshin nga BE-ja si argumente mbi të cilat ajo mund të ndërtonte politikën dhe ndërhyrjet e saj të zhvillimit të territorit. Që atëherë, zgjerimi i BE-së drejt lindjes në 2004 dhe 2007 çliroi forca ekonomike të cilat lanë një shenjë të pashlyeshme në këtë kontinent, duke i hapur rrugën integritimit hapësinor mes lindjes dhe perëndimit (Adams et al., 2011). Teksa stabiliteti ekonomik dhe rritja e qëndrueshme ekonomike, pa dyshim parakushte për arritjen e një stabiliteti politik afatgjatë në BE, karakterizojnë sot shumicën e shteteve anëtare të BE-së, në rastin e Ballkanit Perëndimor proceset e integritimit dhe tranzicionit ende hasin vështirësi. Rajoni karakterizohet nga adaptime strukturore jo

Figure 5 | Figura 5. The Red Octopus | Oktapodi i Kuq

Source | Burimi: Meer (1998)

The Western Balkans and the EU: A Spatial Discontinuity?

The Western Balkans are part of Europe, geographically surrounded by EU Member States. The EU and the region have a common heritage and history, and a future defined by shared opportunities and challenges. The EU has long been strongly engaged in the region; since the Thessaloniki European Council in 2003, it has supported the future of the region as an integral part of the EU. This has been recently reaffirmed by the president of the European Parliament, Donald Tusk, who noted the 'mutual commitment to the European perspective for the whole region' arguing that the EU is and will remain the most reliable partner of the entire Western Balkans (CE, 2018).

In order to overcome the recent legacy of war and disintegration, the various Balkan countries have begun to link their growth prospects with accession to the EU. All countries in the region are currently participating in the EU integration process, each at a different pace (Cotella & Berisha, 2016; Berisha, et al., 2018). However, the actual

të favorshme, të cilat do të hulumtohen në mënyrë më të detajuar në pjesën vijuese të këtij artikulli së bashku me sfidat që ato përfaqësojnë për të ardhmen e projektit të integritit të BE-së.

Ballkani Perëndimor dhe BE-ja: Një mosvijimësi hapësinore?

Ballkani Perëndimor është pjesë e Evropës, gjeografikisht i rrethuar nga shtete anëtare të BE-së. BE-ja dhe ky rajon kanë një trashëgimi dhe histori të përbashkët dhe një të ardhme të përcaktuar nga mundësi dhe sfida të përbashkëta. BE-ja ka qenë prej kohësh fort e angazhuar në rajon; që nga Këshilli Evropian i Selanikut në 2003, ajo ka mbështetur të ardhmen e rajonit si pjesë integrale e BE-së. Kjo është pohuar së fundi nga presidenti i Parlamentit Evropian, Donald Tusk, i cili vuri në dukje 'angazhimin e ndërsjellë ndaj perspektivës evropiane për të gjithë rajonin' duke argumentuar që BE-ja është dhe do të mbetet partneri më i besueshëm i të gjithë zonës së Ballkanit Perëndimor (CE, 2018).

Për të kapërcyer trashëgiminë e luftës dhe të tendencave jo-integruese të kohëve të fundit,

socioeconomic and spatial integration of Western Balkan countries into the EU is yet to come. A first glimpse at development in the Balkans shows how spatial dynamics are still rather different when compared to Western European standards (Uvalić, 1997; Petrakos, 2001; Berisha, et al., 2018). In addition to its geographical distance from the European core, the region is characterized by a high degree of fragmentation, comprising many (relatively small) countries that have rather poor economic interaction.

The present spatial structure of the region reveals discontinuities in the existing axes of development, and does not present any relevant continuum of concentration of people and activities. The Athens–Thessaloniki axis of development has practically no communication with the Skopje–Bitola axis of development in the former Yugoslav Republic of Macedonia, or with the Vlorë–Tirana–Shkodra coastal axis of development in Albania. Only Belgrade shows some potentials for integration within the main EU development corridors. This fact is of major significance since the Western European area has progressively developed a strong spatial dimension, as discussed above. Whereas historical and political divides are progressively being removed, the elimination of the Western Balkans's spatial discontinuity is a crucial challenge that must be faced through interaction and integration between all its actors and territories.

Whereas European policies in the 1990s were not sufficient to promote regional integration effectively, beginning in the 2000s, the EU developed a new comprehensive strategy to support regional and cross border cooperation in the region. Intra–Balkan spatial integration has been recognized by the EU as a *sine qua non* condition in the process of the region's economic integration with the EU in the Stability Pact, announced at the European Council in Cologne (10/06/1999). The Stability Pact offered a framework for dialogue and a channel for action on the Balkan countries, and expressed an international agreement to develop coherent and integrated global policies that supported peace, freedom, stability, reconstruction, and development in the Balkans. Together with the Association and Stabilisation Process for the

vendet e ndryshme të Ballkanit nisën t'i lidhnin perspektivat e tyre të rritjes me hyrjen në BE. Të gjitha vendet e këtij rajoni janë duke marrë pjesë, secili me ritmin e vet, në procesin e integritimit në BE (Cotella & Berisha, 2016; Berisha, et al., 2018). Megjithatë, integrimi i vërtetë socioekonomik dhe hapësinor i vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE ende nuk ka ndodhur. Një vështrim i parë mbi zhvillimin e Ballkanit tregon se sa të ndryshme janë ende dinamikat hapësinore në këtë rajon përkundrejt standardeve të Evropës Perëndimore (Uvalić, 1997; Petrakos, 2001; Berisha, et al., 2018). Përveç distancës gjeografike nga zemra e Evropës, rajoni karakterizohet edhe nga një shkallë e lartë fragmentimi, duke përfshirë një numër të madh vendesh (relativisht të vogla), të cilat kanë një ndërveprim ekonomik mjaft të dobët.

Struktura hapësinore aktuale e rajonit shfaq mosvijimësi në akset ekzistuese të zhvillimit dhe nuk paraqet ndonjë vijueshmëri të konsiderueshme as në përqendrimin e popullsisë dhe të aktiviteteve social-ekonomike. Aksi i zhvillimit Athinë–Selanik praktikisht nuk ka asnjë komunikim me aksin e zhvillimit Shkup–Bitola në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, apo me aksin bregdetar të zhvillimit Vlorë–Tiranë–Shkodër në Shqipëri, dhe vetëm Beogradi shfaq njëfarë potenciali për integrim me korridoret kryesore të zhvillimit të BE-së. Ky fakt ka një rëndësi të madhe pasi zona e Evropës Perëndimore ka zhvilluar në mënyrë progresive një dimension të fortë hapësinor, sikurse u diskutua më lart. Teksa faktorët ndarës, historikë dhe politikë, janë duke u eliminuar në mënyrë progresive, eliminimi i mosvijimësisë hapësinore të Ballkanit Perëndimor është ende një sfidë e rëndësishme, e cila duhet përballur përmes ndërveprimit dhe integritimit të të gjithë aktorëve dhe territoreve të saj.

Ndërkohë që politikat evropiane në vitet 1990 nuk ishin të mjaftueshme për të promovuar integritimin rajonal në mënyrë efektive, duke filluar nga vitet 2000, BE-ja ka zhvilluar një strategji të re gjithëpërfshirëse për të mbështetur bashkëpunimin rajonal dhe ndërkufitar në rajon. Integrimi hapësinor brenda Ballkanit është përcaktuar nga BE-ja, në Paktin e Stabilitetit të deklaruar në Këshillin Evropian në Këln (10/06/1999), si një kusht *sine qua non*² për procesin e integritimit ekonomik të këtij rajoni me BE-në. Pakti i Stabilitetit ofroi një hapësirë për dialog dhe një

integration of the Western Balkan countries into European structures, it fostered concrete policies and programs for market integration, cross border infrastructure, and the development of new regional institutions (Berisha et al., 2018)

As a consequence, the region is now moving towards higher intra-regional market integration, increasing both returns and economic growth. The concomitant regional increase in trade and investments is reinforcing the transfer of ideas, know-how, and technology and increasing understanding between people. All of this needs to be accompanied by higher political cooperation between countries and further political stabilisation in the region. The economic, political, and spatial fragmentation that still characterise the region, as well as existing ethnic rivalries and regional instability, are major factors that impede investments, trade, structural changes, economic reforms, and growth. Further obstacles to regional economic integration include: insufficient cross border infrastructure networks; insufficient services supporting trade; political uncertainties and risks concerning investment activities; and different institutional and administrative frameworks; among others. These challenges should be faced through the progressive adoption of the *acquis communautaire* in the framework of the ongoing accession processes, and in particular through the successful implementation of regional integration measures and cross border cooperation between the various countries. To do so, the countries of the region should recognise that economic prosperity strongly depends on their political and economic cooperation with each other.

kanal për veprim në vendet e Ballkanit, duke qenë manifestimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare që synon të zhvillojë politika globale koherente dhe të integruara në mbështetje të paqes, lirisë, stabilitetit, rindërtimit dhe zhvillimit në Ballkan. Së bashku me Procesin e Stabilizim-Asociimit për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në strukturat evropiane, ai mbështeste politika dhe programe konkrete për integrimin e tregut, infrastrukturat ndërkufitare dhe krijimin e institucioneve të reja rajonale (Berisha et al., 2018).

Si pasojë, rajoni sot është duke përparuar drejt një integrimi më të madh të tregut të brendshëm, duke shtuar fitimet dhe rritjen ekonomike. Rritja në të njëjtën kohë e tregtisë dhe investimeve është duke imponuar mes popujve shkëmbimin e ideve, kompetencave teknike dhe teknologjisë, si dhe duke rritur mirëkuptimin mes tyre. E gjithë kjo nevojitet të shoqërohet nga një bashkëpunim më i madh politik mes vendeve dhe nga një stabilitet më i madh politik në rajon. Fragmentimi ekonomik, politik dhe hapësinor që ende karakterizon rajonin, si dhe rivaliteti etnik ekzistues dhe mungesa e stabilitetit në këtë rajon, janë faktorët kryesorë që pengojnë investimet, tregtinë, ndryshimet strukturore, reformat ekonomike dhe rritjen. Pengesa të tjera ndaj integritimit ekonomik të rajonit janë rrjetet e pamjaftueshme të infrastrukturave ndërkufitare, shërbimet e pamjaftueshme të mbështetjes së tregtisë, pasiguritë në aspektin e politikës dhe rreziqet që lidhen me veprimtaritë e investimit, strukturat e ndryshme institucionale dhe administrative etj. Të gjitha këto sfida duhet të përballen përmes adoptimit gradual të *acquis communautaire* në kuadrin e proceseve të hyrjes në BE që tashmë kanë nisur dhe në veçanti përmes zbatimit të suksesshëm të masave rajonale të integritimit dhe kooperimit ndërkufitar mes vendeve të ndryshme. Për ta bërë këtë, të gjitha vendet e rajonit duhet të kuptojnë se mirëqenia ekonomike varet shumë nga bashkëpunimi i tyre politik dhe ekonomik brendapërbrenda rajonit.

Shënime

1. Termat 'territor' dhe 'hapësirë' përdoren në mënyrë të njëjtë në këtë artikull.
2. Kusht i domosdoshëm.

References | Referenca

- Adams, N., Cotella, G. & Nunes, R.J., 2011. *Territorial Development, Cohesion and Spatial Planning: Knowledge and Policy Development in an Enlarged EU*. London: Routledge.
- Berglof, E., Burkart, M., Friebel, G. & Paltseva, E., 2008. Widening and Deepening: Reforming the European Union. *The American Economic Review*, 98(2), pp.133-37.
- Berisha, E., Colic, N., Cotella, G. & Nedović-Budić, Z., 2018. Mind the Gap: Spatial Planning Systems in the Western Balkan Region. *Transactions of the Association of European Schools of Planning*, 2(1), pp.47-62.
- Brunet, R., 1989. *Les Villes 'Européennes': Rapport pour la DATAR*. Paris: La Documentation Française.
- CE, C.o.t.E.U., 2018. Remarks by President Donald Tusk after the Western Balkan Summit. In *STATEMENTS AND REMARKS*. Bruxelles, 2018. Press office - General Secretariat of the Council.
- CEC, C.o.t.E.C.E.2., 1994. *Cooperazione per lo Sviluppo del Territorio Europeo*. Luxembourg: Office for the Official Publications of the European Communities.
- CEC, 1996. *Scenarios of Spatial Development of Central and Eastern European Countries*. Luxembourg: Office for the Official Publications of the European Communities.
- CEC, o.t.E.C., 1999. *SSSE - Schema di Sviluppo dello Spazio Europeo. Verso uno Sviluppo Territoriale Equilibrato e Sostenibile dell'Unione Europea*. Luxembourg: Office for the Official Publications of the European Communities.
- Cheshire, P., Carbonaro, G. & Hay, D., 1986. Problems of Urban Decline and Growth in EEC Countries: Or Measuring Degrees of Elephantness. *Urban Studies*, 23(2), pp.131-49.
- Cheshire, P. & Magrini, S., 1999. Evidence on the impact of Territorially Competitive Policy and the Role of Transactions Costs in Conditioning Collective (in) Action. *Research Papers in Environmental and Spatial Analysis*, (57).
- Cotella, G. & Berisha, E., 2016. Changing Institutional Framework for Spatial Planning in the Western Balkan Region. Evidences from Albania, Bosnia Herzegovina and Croatia. *Europa XXI*, 30, pp.41-57.
- Dühr, S., 2007. *The Visual Language of Spatial Planning: Exploring Cartographic Representations for Spatial Planning in Europe*. London; New York: Routledge.
- Faludi, A., 2001. *European Spatial Research and Planning*. Andreas Faludi ed. Cambridge, Massachusetts: Lincoln Institute of Land Policy.
- Gorzelak, G., 1996. *The Regional Dimension of Transformation in Central Europe*. London: Routledge.
- Kotios, A., Saratsis, Y., Kalioras, D. & Metaxas, T., 2005. Balkans and Europe: Identifying Spatial. *MPRA Paper*, (42298).
- Kunzmann, K.R. & Wegener, M., 1991. The Pattern of Urbanisation in Western Europe 1960-1990. *Report for the Directorate General XVI of the Commission of the European Communities as Part of the Study 'Urbanisation and the Function of Cities in the European Community'*, 58(350-351), pp.282-91.
- Meer, L.v.d., 1998. The Red Octopus. A New perspective for European Spatial Development Policies, pp.9-26.
- Mehlbye, P., 2000. Global Integration Zones: Neighbouring Metropolitan Regions in Metropolitan Clusters. *Informationen zur Raumentwicklung. Special issue 'Europäische Metropolregionen'*, No. 11-12, pp.755-62.
- Petrakos, G., 2001. The Balkans in the New European Economic Space: Problems of Adjustment and Policies of Development. Paper Prepared for the PHARE ACE Project: Overcoming Isolation: Strategies of Development and Policies of Cross – Border Cooperation in South-Eastern Europe. *Eastern European Economics*, 40(4), pp.6-30.
- Schön, K.P., 2000. Das Europäische Raumentwicklungskonzept und die Raumordnung in Deutschland. *Informationen zur Raumentwicklung (IzR)*, I-VII(3/4).
- Uvalić, M., 1997. European Economic Integration: What Role for the Balkan. In Bianchini & U. Milica, eds. *The Balkans and the*

Challenge of Economic Integration: Regional and European Perspectives. Italy: Longo Editore Ravenna.

- Williams, R., 1996. *European Union Spatial Policy and Planning*. London: Paul Chapman.

ORCID

Giancarlo Cotella: <https://orcid.org/0000-0001-8445-412X>

Disclosure statement

No potential conflict of interest was reported by the author.